

VENDIM
Nr.37, datë 21.3.2008

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RISHIKIMIN E RREGULLORES SË
PROCEDURAVE TË LICENCIMIT**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 18, pika 1 germa “g”, dhe 26, të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.44 datë 24.7.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.3.2008, pasi u njoh me propozimin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi nevojën për një shtesë në rregullat e procedurave të licencimit lidhur me afatet e licencimit për veprimtaritë e eksportit dhe importit të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për rishikimin e rregullores për procedurat e licencimit.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut për hartimin e ndryshimeve në rregullore.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta